

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.H. nga , për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 pika 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.1264/2013, prej datës 12.07.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 24.05.2016, në prezencën e prokurores së shtetit Bahtie Ademi dhe të akuzuarit R.H. shpalli dhe komunikoi publikisht, ndërsa më dt.30.05.2016, përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i:

R.H., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i pa dënuar më parë për veprë penale, udhëhiqet procedurë edhe për një veprë tjetër penale, (ka qenë në paraburgim nga data 03.07.2013 deri më datë 18.07.2013) .

Ë s h t ë f a j t o r

Me datë 02.07.2013, rreth orës 23:50 minuta, në, në, i pandehuri pasi kthehet në gjendje të dehur pa ndonjë shkas e sulmon fizikisht të dëmtuarën, M.H., në atë mënyrë që duke e goditur me papuçë në pjesën e fytyrës, me duar dhe këmbë të cilës me anën e këtyre goditjeve i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, për të cilat lëndime ekziston ekspertiza mjeko ligjore e datës 09.06.2014.

-me çka ka kryer veprën penale: lëndim i lehtë trupor neni 188 paragrafi 3 pika 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 45, 73, 75, 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

E g j y k o n

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit,

Të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim nga data 03.07.2013 deri më datë 18.07.2013 do t'i llogaritet në shqiptimin e dënimit.

E dëmtuara M.H. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Gjilani, me aktakuzën PP.II.nr.1264/2013, të dt.12.07.2013, si në hyrje të aktgjykimit ka akuzuar R.H. nga , për shkak veprës penale: lëndim i lehtë trupor neni 188 paragrafi 3 pika 3.1 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, pranë të cilës aktakuzë ka mbetur deri në fund të shqyrtimit fillestar.

E dëmtuara M.H. ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin përfaqësuesja e akuzës Bahtie Ademi, të akuzuarit ia ka lexuar aktakuzën PP.II.nr. 1264/2013, të dt.12.07.2013,

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e Shtetit i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzën e prokurorit të shtetit nga Gjilani, e ndien veten fajtor, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, ka qenë në gjendje të dehur dhe nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e veta, nuk ka pasur qëllim që ta lëndoj të dëmtuarën, asnjëherë më nuk kanë pasur probleme, është mbajtës i familjes, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, i kërkon falje të dëmtuarës, premton se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, andaj kërkon nga gjykata t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit .

Meçë i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjyqtarja ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 pika 1.1,1.2,1.3,dhe 1.4 të KPPRK- së , se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është kontestuar nga i akuzuari se përmban shkelje ligjore apo gabime faktike.

Andaj gjykata nuk zhvilloi prova në shqyrtimin fillestar nga se gjendja faktike nuk është kontestuar nga i akuzuari.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 74 të KPRK –së ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rënd, ashtu që gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori: pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte të tij në gjykatore, pendimin, premtimi se nuk do të ndeshet më me ligjin, gjendjen jo të mirë ekonomike, kërkim faljen publike të dëmtuarës, mbajtës i familjes, e dëmtuara nuk iu ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, ndërkaq nuk ka gjete rrethana veçanërisht rënduese, andaj gjykata konsideroi se edhe dënimi i shqiptuar prej 30 ditëve burg efektiv do të arrijë te i akuzuari qëllimin e dënimit, i parashikuar sipas dispozitave ligjore nga neni 4 , 41, 74, 75, 76 të KPRK-së, nga se qëllimi i dënimit është që kryerësin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj risocializimin e tij, andaj bazueshëm mund të pritët që dënimi i shqiptuar do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit dhe do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

E dëmtuara M.H. nuk parashtrroi kërkesë pasurore juridike.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet procedurale gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat si më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE KAMENICE-

P.nr.263/2013, më datën 30.05.2016.

Sekretare Juridike

Gj y q t a r j a

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.